



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

V E N D I M

Nr. 08 Datë 22.07.2021

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR 4/MUJORIN E I-RË TË VITIT 2021 PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2021, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit", Ligjin 88/2019 "Per Buxhetin e Vitit 2020", VKQShkoder nr.16, datë 30.12.2020 "Mbi miratimin e buxhetit te Këshillit te Qarkut Shkodër për vitin 2021 dhe PBA Përfundimtare 2021-2023", Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, " për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19", si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 "për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, , pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **11 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

VENDOSI;

1. Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4/mujorin e parë të vitit 2021 dhe tabelat e realizimit të buxhetit , pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;
 - a) Raportin e shpenzimeve sipas programeve
 - b) Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve
 - c) Projektet e investimeve me financim të brëndshëm.
 - d) Treguesit Financiare
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Hilmi LAKTI



**KËSHILLI QARKUT SHKODËR**

Shkodër me 20/05/2021

Raport mbi zbatimin e monitorimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për periudhën 4/mujore Janar – Prill 2021**1- Hyrje**

Realizimi i buxhetit për Këshillin e Qarkut Shkodër Buxhetit per periudhen 4/mujore, Janar – Prill 2021, është bërë duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015”Për Vetëqeverisje Vendore”, nenin 48 të Ligjit Nr.68/2017 ”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008” Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”,i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr 22, datë 30.07.2018 ”Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit te Njësiive të Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe Vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër nr.16,datë 30/12/2020 “Mbi miratimin e buxhetit të KQSH për vitin 2021”.

Qarku , si njësi e nivelit të dytë të Vetëqeverisjes Vendore, ushtron funksionet e veta për ndërtimin e zbatimin e politikave rajonale duke bërë harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror për Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) si dhe kryen funksione te tjera qe i delegohen nga bashkitë e qarkut në zbatim të marreveshjeve të lidhura mes palëve. Programi Buxhetor Afatmesem, parashikon mbulimin sa me efçencë të funksioneve te tij, për të zbatuar politikat dhe misionin e ngarkuar.

Këshilli i Qarkut Shkodër, menaxhon fondet duke u bazuar ne programet e mëposhtme ;

- ✓ **P1-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut (Planifikim, menaxhim, administrim).**
- ✓ **P1-01160-Programi i administratës Vendore të qarkut, funksion i deleguar (DAMT).**
- ✓ **P8- 04520-Programi i Rrjetit Rrugor.**
- ✓ **P9-04760- Programi per Mbeshtetje dhe implementim i projekteve ne kuadër te politikave rajonale per zhvillim ne fushen e turizmit**
- ✓ **P16-06330-Programi i furnizimit me ujë.**
- ✓ **P25-10460-Programi ne fushën e Shërbimeve te Përkujdesjes në qarqe**

2- Përshkrim i Përgjithshëm mbi procesin e monitorimit dhe realizimi i buxhetit.



Sipas nenit 38 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika 1 dhe 2, qarku krijon të ardhura nga burimet e veta vendore dhe të ardhura që rrjedhin nga burime kombetare.

Të ardhurat nga përgjithshme vendore për vitin 2021 janë

- Transferta e pakushtezuar për kryerjen e funksioneve të KQSh është 56,661 mijë lekë.
- Transferta e kushtezuar për kryerjen e funksioneve të deleguara është 5,592 mijë lekë.
- Tarifa për shërbime Publike e planifikuara 300 mijë lekë dhe kuota e antarësisë e përcaktuar me VKB të 5 njësi vendore të qarkut Shkodër është 2,940 mijë lekë.
- Të ardhura të trashëguara nga viti 2020 në shumën 41,618 mijë lekë

Për vitin 2021, të Ardhurat e planifikuara të Këshillit të Qarkut Shkodër, do të jenë 3,240 mijë lekë, nga të cilat të ardhurat nga shërbimet do jenë 300 mijë lekë dhe nga Kuota e Antarësisë për Bashkitë e qarkut Shkodër do të jetë në masën 2,940 mijë lekë, sipas Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 3, datë 08.04.2021 dhe shprehje ligjore nr. 335/1, datë 21.04.2021, por e papërfshirë në buxhetin e periudhës 4/mujore 2021, meqë nuk është bërë shtesa e planit në degën e thesarit, pra për efekt të rakordimit me SIFQ.Jemi në fazën e lidhjes së marrëveshjeve me Bashkitë e qarkut Shkodër.

a- Realizimi i të Ardhurave.

Të ardhurat e realizuara deri më 30.04.2021 në lekë, paraqiten si më poshtë;

- Të ardhura nga kuota e antaresise	0 leke
- Të ardhura nga shërbime kadastrale	9,500 lekë
- Të ardhura nga konfirmim hartash	13,000 lekë
- Të ardhura nga nxjerrje doc.arshivore	1,400 leke
- Të ardhura Gjithsej	23,900 leke

Kuota e antarësisë e miratuar në mbledhjen e Këshillit të Qarkut Shkodër me datën 08.04.2021, nga Bashkitë e qarkut Shkodër është;

➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	1,600,000 lekë
➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali	2,940,000 leke

Plani total i të ardhura nga shërbimet për 4/mujorin e parë është planifikuara në shumën 80 mijë lekë dhe realizimi është në masën 23.9 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave është 29.9% nga sa ka qenë i planifikuara.

Plani analitik i të Ardhurave dhe realizimi për 4/mujorin e I-rë të vitit 2021, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme;

Në 000/lekë

Nr	EMERTIMI	Plani	Plani	Fakti	Realizimi
		12/mujor	4/mujor	4/mujor	Ne %
1	Te ardhura nga kuota Qarkut per 2021	0	0	0	0%
2	Te ardhura nga sherbime të DAMT	100	30	9.5	31.7%
3	Te Ardh.konf.hartash	100	25	13	52 %
4	Tarifanxj.Doc.arshivore	100	25	1.4	5.6%
Totali		300	80	23.9	29.9%

Siç shihet nga tabela e mesiperme:

Te Ardhurat e planifikuara për periudhën 4/mujore kane qene 80 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 23.9 mijë lekë ose 29.9 % e tyre.

Te ardhurat që janë planifikuar për kryerje shërbimesh, si efekt i kompetencave ligjore qe kane qarqet, jane pothuaj të pakonsiderushme.

b-Realizimi i shpenzimeve buxhetore.

Gjatë 4/mujorit te parë të vitit 2021 ne Keshillin e Qarkut janë realizuar shpenzimet sipas programeve të planifikuar buxhetore sic jane ;

- ✓ P1-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut (Planifikim, menaxhim, administrim).
- ✓ P2-01160- Programi i administratës Vendore të qarkut ,funksion i deleguar(DAMT).
- ✓ P8- 04520- Programi i Rrjetit Rrugor.
- ✓ P9-04760- Programi per Mbeshtetje dhe implementim i projekteve ne kuadër te politikave rajonale per zhvillim ne fushen e turizmit
- ✓ P16-06330- Programi i furnizimit me ujë.
- ✓ P25-10460- Programi ne fushën e Shërbimeve te Përkujdesjes në qarqe.

Siç shihet nga aneksi nr. 1"Raporti i shpenzimeve sipas programeve", realizimi i buxhetit i peridhës 4 /mujorë eshtë në masen 11.05 %. Kjo kryesisht si rezultat i Programit P16-Programi i furnizimit me ujë, pasi per investimen e planifikuar, nuk jane kryer procedurat e prokurimit si rezultat i bllokimit te prokurimit nga vonesa ne nxjerrjen e lejes së ndërtimit dhe

ndryshimeve te ligjit të prokurimit publik.

3- Realizimi sipas Programeve;

✓ **PI-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut (Planifikim, menaxhim, administrim)**

Ky program përfshin planifikimin, menaxhimin nga ana e administrative te institucionit tone, per te mundesuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave të kuadrit ligjor ne fuqi.

Siç shihet nga aneksi 2, Buxheti vjetor 2021 për këtë Program është 36,206 mijë lekë ose 30.72 % e buxhetit total të Këshillit të Qarkut Shkoder.

Ky program perfshin;

- Shpenzimet e personelit nga tranferta e pakushtezuar e vitit 2021. Kemi synuar sigurimin e mbeshtetjes së funksionimit të administrates se KQShkodër përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore të cilat për 4/mujorin e parë shpenzimet për paga, janë realizuar ne masen 90.6%, ndersa për sigurime shoqërore janë realizuar ne masen 88.87 %.Zbatimi i buxhetit për shpenzime përsonele u bazua te numri i punonjësve i cili per keshillat e qarqeve eshte i përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit me 10 punonjës administrativ dhe 3 të zgjedhur si dhe ne nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, brënda kufirit minimal dhe maximal te miraruar.Pagat bëhen në zbatim të VKM-së nr. 165,date 02.03.2016, i ndryshuar.
- Shpenzimet operative janë planifikuar ne 4/mujorin e pare në masen 3.200 mijë lekë dhe jane realizuar 1,009 mijë lekë.
Realizimi i aktiviteteve të këtij programi për shpenzimet operative për funksionimin e administratës së qarkut Shkodër është realizuar në masën 31.53% duke konsideruar vetem likuidimet fakt te shpenzimeve pa llogaritur kontratat vjetore per sherbime, karburant , roje etj,.
- Transferta korrente te brendshme , ze i cili përfshin transferta që Keshilli i Qarkut Shkodër bën në zbatim të VKM-ve dhe Vendimeve të Keshillit. Per 4 mujorin e parë realizimi dhe planifikimi është 0.
- Transferta korrente të jashtme perfshijnë kuotazicionet qe qarku paguan ndaj organizatave partnere ku aderon si CPMR dhe EUSAIR .Per 4 mujorin realizimi dhe planifikimi është 0.
- Transferta tek buxh familjare perfshin shumat qe i paguhen punonjesve per persona ne ngarkim sipas VKM, dhe ky shpenzim eshte kryer per 4/mujorin e parë dhe likuiduar në muajin maj 2021.
- Ne shpenzime kapitale te këtij programi janë planifikuar shpenzime per paisje zyrash te cilat jane planifikuar në këtë katër mujor dhe janë realizuar në masën 0 %.

Realizimi total i ketij programi per 4 mujorin e parë të vitit 2021, eshte ne masen 67.21 %. Siç shihet kjo % e ulet e mosrealizimit të planit ka qenë rrjedhojë e disa aktiviteteve të planifikuara për tu realizuar por qe për arsye të masave antiCovid, nuk jane realizuar.

✓ **P2-01160- Programi i administratës Vendore të qarkut, funksion i deleguar (DAMT).**

Këshilli i Qarkut shkodër, në varësi të tij ka edhe DAMT-në , i cili ushtron aktivitetin e vet me fonde të kushtëzuara nga Ministria e Brëndshme .

Zbatimi i Buxhetit për periudhën janar deri 30 prill 2021, është i pasqyruar ne Aneksin 2.program 01160.

Ky program perfshin;

- koston e personelit nga tranferta e kushtezuar e vitit 2021 e cila për 4/mujorin per paga është realizuar ne masen 73.10%, ndersa për sigurime shoqërore është realizuar ne masen 75.98 %. Zbatimi i buxhetit për shpenzime përsonele u bazua tek numri i punonjësve i cili per DAMT, është i përcaktuar me 6 punonjës administrativ dhe në nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pagat bëhen në zbatim të VKM-së nr. 187,date 08.03.2017. Theksoj se për 4/mujorin e parë te ketij viti, nga 6 punonjës të planifikuar, në fakt kanë qenë 5 punonjës, prandaj dhe niveli i realizimit është më i ulët.
- Shpenzimet operative të cilat për 4/mujorin e parë 2021, janë planifikuar në masën 140 mijë lekë, nuk janë realizuar por është punuar me fondet e qarkut.

Realizimi total i ketij programi per 4 mujorin e parë të vitit 2021, është ne masen 69.76 % dhe ka patur realizime vetëm në zërin paga dhe sigurime shoqërore.

✓ **P8- Programi i rrjetit Rrugor.**

Investimi i planifikuar që në vitin 2020 për investimin ne Bashkinë Fushë Arrëz” Rikonstruksion, asfaltimi rrugeve të brëndshme në qytetin e Fushë Arrësit“ në shumen 4,000 mijë lekësh, i cili për arsye objektive nuk është realizuar në vitin e kaluar, ka qenë i planifikuar të realizohej gjatë 4/mujorit të parë te vitit 2021.

Prokurimi me objekt “Rikonstruksion, Asfaltim i Rrugëve të Brendshme” në Qytetin Fushë-Arrëz, është zhvilluar në vitin 2020 me REF-73284-09-28-2020, menjëherë pas administrimit të dokumentacionit teknik nga Bashkia Fushë Arrëz, por është anuluar më datë 23.10.2020, sepse i vetmi ofertues,^[1] që kishte dorëzuar dokumentet në sistemin elektronik, nuk kishte plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi për prokurimin publik. Ndërkohë është rishpallur sërish në vitin 2021 me REF-86908-02-12-2021, por përsëri është anuluar sepse dy ofertuesit pjesmarrës, përkatësisht bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini 1” shpk dhe “Ndërtuesi 2014” sh.p.k. dhe “Delia Impex” sh.p.k. nuk plotësonin kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për herë e tretë, në zbatim të ligjit të ri nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, është ripërgatitur dosja e tenderit tenderi me objekt “Rikonstruksion, Asfaltim i Rrugëve të Brendshme” me REF-94394-05-01-2021 është rishpallur në Buletin dhe në sistemin elektronik, ku është përcaktuar data e hapjes së ofertave 17.05.2021, ora 11:00. Por, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi ka hyrë në sistem ka konstatuar se nuk ka pasur asnjë ofertë. Në këto kushte tenderi duhet të anulohet përsëri.

✓ **P9-Programi per Mbeshtetje dhe implementim i projekteve ne kuader te politikave rajonale per zhvillim ne fushen e turizmit**

Këshilli i Qarkut Shkodër, për vitin 2021 ka planifikuar fonde për bashkëfinancime me projekte me financim të huaj në zbatim të udhëzimit të Ministrise se Financave për Projektet me Financim të Huaj nr.35, datë 21.09.2020.

Meqenese ne kemi aplikuar në disa projekte kryesisht ne fushen e turizmit, kemi bere planifikimin ne kete program në shumen 500 mijë lekë nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2021 dhe 3,434 nga të Ardhurat e trashëguara për tu realizuar dhe të ardhurat e vitit 2021.

Edhe pse ne kemi aplikuar ne disa projekte, gjatë 4/mujorit te parë të këtij viti, nuk kemi apatur asnjë përgjigje nga programet në të cilat ne kemi aplikuar. Mbesim në pritje të përgjigjeve gjatë muajve të ardhshëm.

Per arsye të përdorimit të fondeve të këtij programi vetëm për bashkëfinancime me projekte, siç shihet nga aneksi 2 bashkangjitur, ku fakti i shpenzimeve per vitin 2020 eshte 0 dhe planifikimi për 4/mujorin e parë është 0, nuk është plotësuar aneksi 3 per treguesit e performancës.

✓ **P16-06330-Programi i furnizimit me ujë.**

Në buxhetin e vitit 2021, kemi planifikuar fonde për hartimin e projektit “Ndertimi i Ujësjiellësit Muriqan, Bashkia Shkodër” në shumën 51,361 mijë lekësh për vlerë investimi përfshirë edhe mbikqyrjen dhe kolaudimin e investimit.

Në zbatim të marreveshjes se lidhur mes Këshillit të Qarkut Shkodër dhe AKUM , me shkresen nr. 340, datë 12.02.2021 te Min. Infrastrukturës dhe Energjisë, është dërguar detajimi i buxhetit per vitin 2021 në shumën 10,983 mijë lekë vlerë investim dhe 259 mijë lekë për supërvizion punimesh. Gjithashtu në këtë shkresë është dërguar edhe shuma e parashikur në PBA për vitet 2022 dhe 2023 respektivisht 10,983 mijë lekë vlerë investimi dhe 259 mijë lekë për supërvizion punimesh për vitin 2022 dhe 32,949 mijë lekë vlerë investimi dhe 777 mijë lekë për supërvizion punimesh për vitin 2023.

Për Investimin e planifikuar në buxhetin e vitit 2021 për “Ndertimi i Ujësjiellësit Muriqan, Bashkia Shkodër” me datën 26 .04.2021 është miratuar leja e ndertimit të objektit nga Bashkia Shkodër dhe kemi filluar me kryerjen procedurave për hedhjen e prokurimit në app.

✓ **P25-10460- Programi ne fushën e Shërbimeve te Përkujdesjes në qarqe.**

Për vitin 2021, nga Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale është akorduar fondi në shumen 3,024 mijë lekë per periudhen 6/mujore me shkresën nr. 899/2, datë 19/02/2021 ”Transferim i fondeve për financim në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qarqe për periudhën janar – Qeshor 2021”, nga Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shteteror, te cilat do të përdoren për shpenzime korrente sipas nevojave te shtëpisë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”.

Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, ushtron aktivittin e saj prej 25

vitesh dhe strehon 17 persona me aftësi të kufizuara të gropmohës 30-60 vjeç.

Misioni i kësaj shoqate është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e integritit social të përfituesve ndërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për persona me aftësi të kufizuara.

Shërbimet që ofrohen në qënder janë;

- # Shërbimi rezidencial,
- # Shërbimi mjeksor
- # Shërbimi psiko-social,
- # Aktivitete sociale ,kulturore,vizita
- # Shërbimi sanitar.

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU




ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"
KESHILLI QARKUT SHKODER

Viti 2021

ne 000/leke

Emri i Grupit		Kodi i Grupit				2033001	
Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore							
Programet	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 4 mujore/progressiv	Fakti i Periudhes 4 mujore/progresiv	Diferenca
Emertimi							
0001	Programi 1	24,471.0	36,206.0	36,206.0	9,346.0	6,282.0	-3,064.0
0002	Programi 1	5,207.0	5,595.0	5,592.0	2,127.0	1,484.0	-643.0
0003	Programi 8	12,507.0	0.0	6,468.0	4,000.0	0.0	-4,000.0
0004	Programi 9	0.0	1,200.0	3,934.0	0.0	0.0	0.0
0005	Programi 16	790.0	25,236.0	62,603.0	62,603.0	200.0	-62,403.0
0006	Programi 25	1,993.0	0.0	3,024.0	1,512.0	831.0	-681.0
.....							
Totali i Shpenzimeve të Njesisë	44,968.0	64,451.0	117,827.0	117,827.0	79,588.0	8,797.0	-70,791.0
Totali	44,968.0	64,451.0	117,827.0	117,827.0	79,588.0	8,797.0	-70,791.0

Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Hilmi JAKTI
	Firma	
	Data	20.05.2021



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke

QARKU	SHKODER							Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2033001
Programi 1	01110							Kodi i Programit
Art.	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	-2 PBA Plan 2021	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishtikuar Viti 2021	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhës 4 Muajore/progressiv				
600	Paga	15000	15000	15000	5000	4530	-6 Fakti Periudhës 4 mujore/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
601	Sigurime Shoqërore	2500	2500	2500	836	743		-470	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	10000	10939	10939	3200	1009		-93	
609	fond rezerve	0	1500	1500		0		-2191	
604	Transferta Korente të Brendshme	700	3495	3495		0		0	
605	Transferta Korente të Huaja	521	300	300		0		0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	35	30	30	10	0		-10	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	30230	33764	33764	9046	6282		-2764	
230	Kapitale të Patrupëzuara							0	
231	Kapitale të Trupëzuara	195	2200	2442	300	0		-300	
232	Transferta Kapitale							0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	195	2200	2442	300	0		-300	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0		0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0		0	
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0		0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0		0	
Totali	Shpenzime Kapitale	195	2200	2442	300	0		-300	
	Totali (korrente + kapitale)	24471	32430	36206	9346	6282		-3064	
Drejtesia e Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyjlana Miruku		Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore						
Firma			Hilmi LAKTI						
Data	20.05.2021		20.05.2021						



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujeve
KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke


QARKU	SHKODER- DAMT									Kodi i Grupit / Njësish Vendore	2033001
Programi 1	01160									Kodi i Programit	
Art.	Emergimi		-1	-2	-3	-4	-5	-6	(7)=(6)-(5)		
	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	Plan PBA 2021 Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 4 Mujore/progressiv	Fakti i Periudhes 4 Mujore/progressiv	Diferenca				
600	Paga	4263	4600	4600	1740	1272	-468				
601	Signime Shoqërore	712	713	713	257	212	-45				
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	232	279	279	130	0	-130				
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0				
604	Transferita Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0				
605	Transferita Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0	0	0	0	0				
Non-Total	Shpenzime Korrente	5207	5592	5592	2127	1484	-643				
230	Kapitale të Patrupëzuara						0				
231	Kapitale të Trupëzuara						0				
232	Transferita Kapitale						0				
Non-Total	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0				
230	Kapitale të Patrupëzuara						0				
231	Kapitale të Trupëzuara						0				
232	Transferita Kapitale						0				
Non-Total	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0				
Total	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0				
	Total (korrente + kapitale)	5207	5592	5592	2127	1484	-643				
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Kryetari Njësish Vetëqeverisjes Vendore		Hilmi LAKTI								
	Firma				Firma						
	Data	20.05.2021			Data	20.05.2021					



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke


QARKU	SHKODER											Kodi i Grupit / Njesisë Vendore
Programi & Art.	04520											Kodi i Programit
Emertimi		-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	-2 PBA Plan 2021	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhës 4 Mujore/progressiv	-6 Fakti i Periudhës 4 mujore/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca		2033001		
600	Paga	0		0	0	0	0	0	0	0		
601	Sigurime Shoqërore	0		0	0	0	0	0	0	0		
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0		0	0	0	0	0	0	0		
603	Subvencione	0		0	0	0	0	0	0	0		
604	Transferita Korente të Brendshme	0		0	0	0	0	0	0	0		
605	Transferita Korente të Huaja	0		0	0	0	0	0	0	0		
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0		0	0	0	0	0	0	0		
Non-Totali	Shpenzime Korrente	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0	0	0	0		
231	Kapitale të Trupëzuara	12507	0	6468	6468	4000	0	0	0	-4000		
232	Transferita Kapitale											
Non-Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	12507	0	6468	6468	4000	0	0	0	-4000		
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0	0	0	0		
231	Kapitale të Trupëzuara	0		0	0	0	0	0	0	0		
232	Transferita Kapitale	0		0	0	0	0	0	0	0		
Non-Totali	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
Totali	Shpenzime Kapitale	12507	0	6468	6468	4000	0	0	0	-4000		
	Totali (korrente + kapitale)	12507	0	6468	6468	4000	0	0	0	-4000		
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gyljana Miruku	Kryetari Njesisë Vetëqeverisjes Vendore										
Firma		Firma										
Data	20.05.2021	Data										



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikuive

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke

QARKU	SHKODER-		-1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	-2 PBA Plan 2021	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	-5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 4 Mujore/progressiv	Kodi i Grupit / Njesisë Vendore Kodi i Programit	2033001
	Programi 9	04760							
Art.	Emertimi								
600	Paga		0	0	0	0	0	0	0
601	Sigurime Shoqërore		0	0	0	0	0	0	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		0	0	0	0	0	0	0
603	Subvencione		0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme		0	1200	3934	3934	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja		0	0	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		0	0	0	0	0	0	0
Non-Totali	Shpenzime Korrente		0	1200	3934	3934	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara		0		0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara								
232	Transferta Kapitale								
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem		0	0	0	0	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara/Projekti ADRIATICVES		0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara								
232	Transferta Kapitale								
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj		0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale		0	0	0	0	0	0	0
	Totali (korrente + kapitale)		0	1200	3934	3934	0	0	0
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyjana Miruku		Kryetari Njesisë Vetëqeveritjes Vendore			Hilmi LAKTI			
Firma			Firma						
Data	20.05.2021		Data						

